

BULETIN Nr. 3
Prill 2019

INTEGRITET LLOGARIDHËNIE PARTNERITET

3





Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

BULETIN Nr. 3
Integritet
Llogaridhënie
Partneritet
Prill 2019

Stafi i IDM dhe bashkëpunëtorët e projektit:

Rovena Sulstarova, Menaxhere Projekti

Besjana Kuçi, Konsulente e Komunikimit

Dalina Jashari, Kontribuese

Redion Qirjazi, Kontribues

Sotiraq Hroni, Konsulent i Lartë

Elsa Toska, Eksperte Ligjore e Etikës dhe Integritetit

Erald Bezhani, Ekspert i Menaxhimit të Riskut Institucional

Për më shumë informacion si dhe për dërgesë të opinioneve, përfaqësuesit e institucioneve vendore mund të na kontaktojnë në adresën e email: info@idmalbania.org ose tel: 042400241

Shënim:

Ky buletin u realizua në kuadër të Projektit: “Ndërtimi i Integritetit për përmirësimin e performancës dhe qëndrueshmëria e luftës kundër korrupsionit në Policinë e Shtetit në Shqipëri” i cili mbështetet nga një grant i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta (Holandës). Objektivat, zbatimi i plotë dhe rezultatet e këtij projekti janë përgjegjësi e organizatës zbatuese – Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Çdo qëndrim apo opinion i shprehur në këtë projekt është i organizatës zbatuese dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të qeverisë holandeze.

NË VEND TË HYRJES

RËNDËSIA E ZHVILLIMIT TË
PLANIT TË INTEGRITETIT PËR
POLICINË E SHTETIT 3

NË FOKUS

SERIA E TAKIMEVE PUBLIKE
LLOGARIDHËNËSE PËR
PARANDALIMIN E KRIMIT

Selenicë: Më shumë
komunikim ndërmjet
institucioneve, më shumë
zgjidhje për komunitetin 6

Bashkia Librazhd: Takimet
llogaridhëse një nismë për
t’u shtrirë në të gjitha njësitë
administrative 8

Mat: Grupi rinor “Zëri 16+”
kërkoj marrjen e masave
lidhur me shqetësimet e të
rinjve në shkolla 10

PLANI I INTEGRITETIT

PLANI I INTEGRITETIT NË
KOMISARIATIN NR. 1 TIRANË 11

SERIA E TAKIMEVE PUBLIKE
LLOGARIDHËNËSE PËR
PARANDALIMIN E KRIMIT

Bashkia Tiranë /Njësia
nr. 7 & nr. 5: Komunikimi i
vazhdueshëm me policinë
i domosdoshëm për ndarje
më të mirë të përgjegjësisë
institucionale 13

Qytetarët në Kamëz: Niveli
i ulët i zbulueshmërisë së
ngjarjeve kriminale dhe
pandëshkueshmëria e
shkelësve të ligjit shkak për
besimin e ulët tek institucionet 14

RËNDËSIA E ZHVILLIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT PËR POLICINË E SHTETIT

Nga Erald Bezhani, Ekspert i Lartë i Menaxhimit të Riskut Institucional

Një nga sfidat më të mëdha të cilat kërcënojnë shoqërinë dhe institucionet në ditët e sotme, është prania e korrupsionit dhe praktikave jo etike profesionale. Praktika ka treguar se një nga institucionet më vulnerabël ndaj praktikave korruptive janë edhe strukturat e Policisë. Në këtë prizëm, Plani i Integritetit dhe zbatimi i tij është një prej mjeteve që ka rezultuar të jetë efikas në reduktimin dhe parandalimin e fenomeneve dhe akteve korruptive. .

Në këtë kontekst, Plani i Integritetit është një mjet i cili i shërben institucioneve të Policisë të identifikojë, vlerësojë dhe parandalojë tërësinë e rreziqeve që çënojnë integritetin e institucionit dhe individëve që punojnë në të. Plani i Integritetit është një proces i dokumentuar që vlerëson nivelin e cënueshmërisë së një organizate dhe ekspozimin e saj ndaj korrupsionit dhe praktikave jo-etike profesionale.

SI FUNKSIONON PLANI I INTEGRITETIT?

Qëllimi i tij është eliminimi i shkaqeve ose rreziqeve për shfaqjen dhe zhvillimin e korrupsionit dhe gjithë sjelljeve etike dhe profesionale të papranueshme. Ai ndërton një sinergji mjaft të vlefshme, bazuar në profesionalizmin e të gjithë brezave pranë këtyre institucioneve, duke kombinuar individët me përvojë dhe të rinjtë e bashkuar rishtazi strukturave policore.

Plani i Integritetit synon të krijojë një mënyrë sistematike për të identifikuar të gjitha proceset dhe praktikave të cilat janë në kompleks të administruara nga institucioni. Ky plan qartëson dhe

ndërgjegjëson në mënyrë të vazhdueshme për rolin e përgjegjësive të secilit punonjës brenda strukturave. Ai është mjeti më efektiv për identifikimin e rreziqeve që çënojnë mbarëvajtjen e proceseve kryesore të administruara nga institucioni i Policisë. Nëpërmjet këtij instrumenti bëhet e mundur përfshirja e gjithësecilit në ndërtimin e planeve të veprimit të cilët do të parandalonin, kufizonin apo minimizonin kushtet për shfaqjen e korrupsionit, praktikave jo-etike dhe joprofesionale në të gjitha fushat e funksionimit të këtyre strukturave. Ky plan do të ndihmonte në aspektin praktik duke lejuar të gjitha nivelet të propozojnë masa dhe aktivitete të përshtatshme për zvogëlimin ose eliminimin e këtyre rreziqeve që kanë mundur të identifikojnë.

Qëllimi përfundimtar i zhvillimit të Planit të Integritetit është forcimi i integritetit institucional duke vënë theksin në ndershmërinë, profesionalizmin, etikën personale dhe mënyrën e të vepruarit në përputhje me vlerat morale të komunitetit.

AVANTAZHET E ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

Plani i Integritetit prodhon një tërësi planesh veprimi të cilat krijojnë një dinamikë që ndihmon menaxhimin me efikasitet të strukturave policore dhe kontribuon pozitivisht që ato të jenë të fokusuar kryesisht ndaj rreziqeve që kanosin institucionin në mënyrë të vazhdueshme.

Zbatimi dhe përditësimi i këtyre planeve të veprimit ndihmon në ndërtimin dhe

forcimin e një kulture organizative e cila krijon rezistencë ndaj praktikave korruptive.

Një nga ndikimet kryesore e më të vlefshme të Planit të Integritetit është përforsimi dhe ndërgjegjësimi i mëtejshëm i të gjitha niveleve të drejtimit ndaj një kulture mospranuese dhe parandaluese të korrupsionit.

Plani i integritetit mbetet një pjesë thelbësore e një kuadri më të gjerë në kuptimin e administrimit të rrezikut që i kanoset institucionit. Ai përbën një mekanizëm i cili nxit menaxhimin efektiv institucional dhe kontribuon në mirëqeverisjen e strukturave si një e tërë.

Plani i Integritetit nxit transparencën ndaj palëve të treta e kryesisht komunitetit, ashtu sikurse zhvillon një ndërgjegjësim të vazhdueshëm mbi llogaridhënien dhe promovimin e sjelljeve etike në nivelet e synuara.

Rezultati përfundimtar i zbatimit të Planit të Integritetit do të jetë: thjeshtimi i mëtejshëm i procedurave dhe proceseve komplekse, përmirësimi dhe ndërtimi i një sistemi efektiv i kontrollit të brendshëm, përforsimi e llogaridhënies, rritja e transparencës, përmirësimi i profesionalizmit dhe standardeve të etikës.

PILOTIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT ME KOMISARIATIN NR.1, TIRANË

Në kuadër të krijimit dhe vënies në zbatim të mekanizmit të Planit të Integritetit në Komisaratin nr. 1 të Tiranës, janë shqyrtuar procedurat standarde të veprimit të miratuara nga autoritetet qendrore të Policisë së Shtetit dhe praktikat profesionale të paformalizuara, të cilat janë pjesë e praktikës së punës së kryer nga efektivet e Komisarariatit.

Procesi për ndërtimin e Planit të Integritetit ka kaluar në hapat e mëposhtëm:

- Nëpërmjet shqyrtimit të aktivitetit është bërë e mundur të strukturohen të gjitha proceset dhe nën-proceset e punës të cilat u përkasin fushave si “Rendi dhe Siguria”, “Trajtimi i menaxhimit të konflikteve”, “Policimi në komunitet”, “Patrullimi dhe Patrulla e Përgjithshme” dhe “Hetimi i krimeve”.
- Prej proceseve të identifikuara bazuar edhe në historikun e Komisarariatit, janë ndërtuar skenarët e mundshëm të cilën do të cënonin integritetin individual apo institucional në aspektet e korrupsionit (që përfshin favorizime, ryshfete, dhurata, etj.), llogaridhënies dhe respektimit të hierarkisë së autoriteteve, transparencës dhe komunikimit, konfliktit të interesave, sinjalizuesve të mundshëm, manaxhimit të burimeve njerëzore, imazhit dhe reputacionit të figurës së efektivit të Komisarariatit nr. 1.
- Bazuar në skenarët e ndërtuar dhe metodologjinë e përcaktuar prej këtij mekanizmi, janë realizuar vlerësimet e rrezikut për aspektet që janë pjesë e Planit të Integritetit.
- Në bashkëpunim me efektivet e Komisarariatit janë realizuar edhe vlerësimet e

pikave të kontrollit dhe efektiviteti i tyre për secilin proces apo skenar respektiv.

- Tërësia e risqeve të pambuluara sikundër synohet, bën të nevojshme përgatitjen e Planeve të Veprimit të cilat adresojnë risqet që çenojnë integritetin individual të efektivëve dhe atë institucional të komisarariatit.

Në përfundim të këtij procesi do të realizohet ngritja e një mekanizmi dinamik, i cili ndihmon drejtimin e Komisarariatit nr.1 të adresojë risqet dhe optimizojë proceset me burimet njerëzore që disponohen, për të arritur një menaxhim më efektiv të institucionit në tërësi. Gjithashtu, ky mekanizëm do të ndihmojë në ndërtimin e Planeve të Veprimit që burojnë nga Plani i Integritetit për të adresuar risqet dhe optimizuar proceset me burimet njerëzore që disponohen, për të arritur një menaxhim më efektiv të institucioni si një i tërë.

ÇFARË TRAJTON KY NUMËR I BULETINIT?

Ky numër i Buletinit “Integritet-Llogaridhënie-Partneritet” e vendos theksin tek rëndësia e hartimit dhe zbatimit të Planit të Integritetit në institucionet publike dhe në veçanti për nismën pilotimit të këtij plani në Komisariatin Nr.1 në Tiranë.

Gjithashtu, një rubrikë tjetër e këtij Buletini është ndarja e përvojës së takimeve llogaridhëse për parandalimin e krimit dhe sigurinë vendore në bashkitë Selenicë, Mat, Librazhd, Kamëz dhe Bashkia Tiranë: Njësia 7 & Njësia 5. Ky model takimesh ka për qëllim forcimin dhe institucionalizimin e bashkëpunimit Polici-Bashki-Prokurori me grupet e interesit dhe komunitetin në nivel vendor.

Gjithashtu ofrohet një analizë e fazës së tretë të planit i integritetit e cila po zbatohet në Komisarariatit Nr.1 Tiranë që konsiston në vlerësimin e intensitetit të risqeve të identifikuar dhe trajtimeve të zhvilluara për këtë fazë me punonjësit e këtij komisarati.

Jepni kontributin tuaj me komente dhe shkrime për këtë buletin përmes komunikimit me botuesit tek info@idmalbania.org.

SERIA E TAKIMEVE PUBLIKE LLOGARIDHËNËSE PËR PARANDALIMIN E KRIMIT

NË DIALOG TË HAPUR ME GRUPET E INTERESIT DHE
KOMUNITETIN

SELENICË: MË SHUMË KOMUNIKIM NDËRMJET INSTITUCIONEVE, MË SHUMË ZGJIDHJE PËR KOMUNITETIN

Në ndryshim nga takimet e zhvilluara në bashki të tjera në kuadër të nismës së modelit llogaridhënës polici-bashki-prokurori, në bashkinë Selenicë zuri një vend të rëndësishëm diskutimi mbi përgjegjësinë penale të kryetarëve të fshatrave lidhur me rastet e kultivimit të bimëve të lëndëve narkotike dhe nevojës për një patrullim më të shpeshtë të policisë në zonat e thella rurale.

Kryetari i bashkisë z. Përparim Shametaj e cilësoi takimin si mjaft të rëndësishëm për shkak edhe të disa ngjarjeve të rënda që kanë ndodhur në këtë bashki. “Sigurisht që ky takim nuk i jep zgjidhje të menjëhershme problemeve, por i shërben krijimit të ndjeshmërisë ndaj problematikave në të gjitha hallkat institucionale dhe në komunitet. Këtë format takimi do ta shtrijmë në të gjitha njësitë administrative e në të gjitha fshatrat”, tha z. Shametaj. Më tej ai theksoi se më shumë vëmendje duhet të ketë për zonat rurale pasi aty problematikat janë më të shumta dhe investimet edhe nga qeveria kanë qenë më të pakta.

Shefi i Komisarariatit të Policisë Vlorë Z. Alket Ahmetaj nënvizoi rolin e rëndësishëm të komunitetit në parandalimin e kriminalitetit. Përgjatë 2018, shqetësim dhe prioritet i policisë

Vlorë ka qenë parandalimi i kultivimit të bimëve narkotike. Kjo sfidë për policinë kërkon bashkëpunimin edhe të komunitetit. Gjithashtu z. Ahmetaj përmendi shpërndarjen e lëndëve narkotike në afërsi të shkollave dhe dhunën në familje si prioritete të punës së policisë. Për të zgjidhur këto problematika nevojitet një hetim në kohë dhe vlerësim i saktë i ngjarjes nga ana e policisë në mënyrë që të parandalohet kalimi nga konfliktet banale në ato të rënda.

Prokurorja e prokurorisë së rrethit zj. Elona Alvora theksoi se aktorët e ndryshëm vendorë duhet të ndërveprojnë me njëri-tjetrin. **Synimi kryesor është që secili institucion të marrë masa për të adresuar problemet si p.sh. bashkia mund të ngrejë një strukturë për asistencë kundër dhunës në familje dhe të japë informacion për qytetarët për mbështetjen që ofrohet, tha zj. Alvora.** Për rastet e konflikteve për pronësinë, prokurorja rekomandoi ndjekjen në formë zyrtare institucionale të çështjeve për shmangur konfliktet e rënda. Gjithashtu, ajo nënvizoi rolin e qeverisjes vendore në marrjen e masave administrative për këto raste që në këtë mënyrë të vihet në lëvizje edhe prokuroria.



Për shkak të problematikave të shumta në këtë zonë, pjesëmarrësit ishin shumë aktivë në parashtrimin e shqetësimeve që lidheshin me konfliktet e përsëritura të pronësisë, problemet e dhunës në shkolla, përgjegjësitë e shtuara të kryetarëve të fshatrave në parandalimin e kultivimit të lëndëve narkotike dhe problemet e infrastrukturës së dobët të bashkisë Selenicë.

Kryetarët e fshatrave shtruan për diskutim mungesën e reagimit në kohë nga ana e policisë gjatë konflikteve ndërmjet fshatarëve. Gjithashtu, “çështja e përgjegjësisë penale për kryetarët e fshatrave në rast të evidentimit të kultivimit të bimëve narkotike nuk është proporcionale me rolin e kryetarit të fshatit dhe kushtet e vështira në të cilën duhet ta kryejë këtë funksion”- u shpreh një kryetar fshati. Në këtë aspekt, u bë thirrje për patrullime më të shpeshta nga ana e policisë në zonat e thella rurale për problemin e kultivimit të lëndëve narkotike.

Një përfaqësues i shoqërisë civile cilësoi si të domosdoshme punën për parandalimin përmes ndërgjegjësimit të komunitetit nga kryetarët e fshatrave në të gjitha zonat, **“Këshilli Bashkiak duhet të jetë më aktiv për çështjet e rendit dhe sigurisë publike. Sa më tepër**

komunikim ndërmjet institucioneve, aq më shumë zgjidhje do të ketë për komunitetin. Këshilli Vendor i Sigurisë Publike i ngritur pranë bashkisë Vlorë është një model i ri që përbëhet nga të gjitha grupet e interesit dhe do të shërbejë për të adresuar problematikat dhe referimin e tyre në institucionet përgjegjëse”- theksoi znj. Dhimitri nga “Qendra Rinore e Vlorës”.

Gjithashtu, problematika e rasteve të dhunës ndërmjet nxënësve nëpër shkolla është kthyer në një shqetësim për mësuesit dhe drejtuesit e shkollave që kërkuan zgjidhje dhe marrjen e masave për këtë fenomen nga përfaqësuesi i policisë. **Për këtë çështje, prokurorja ritheksoi rolin e bashkisë sipas kodit për drejtësinë penale për të miturit i cili parashikon krijimin e një strukture pranë njësisë vendore për të miturit dhe kjo njësi duhet të referojë rastet në polici.** Njëherazi, ky mekanizëm i ri do të kërkojë bashkëpunimin e institucioneve me komunitetin edhe për të realizuar ndërmjetësimin për raste të caktuara.

BASHKIA LIBRAZHDE: TAKIMET LLOGARIDHËNËSE NJË NISMË PËR T'U SHTRIRË NË TË GJITHA NJËSITË ADMINISTRATIVE



Takimi llogaridhënës në Librazhd u hap nga kryetari i bashkisë, z. Kastriot Gurra, i cili nënvizoi efektet e reformës territoriale dhe kompetencave të shtuara për bashkitë në lidhje me çështjet e sigurisë. Ai solli në vëmendje krijimin e Këshillit Vendor për Siguri Publike që ka në përbërje të gjithë aktorët vendorë për të adresuar çështjet e rendit dhe të sigurisë dhe që mbledhet në mënyrë periodike. Ashtu siç u angazhua bashkia Shkodër, edhe për bashkinë Librazhd, z. Gurra përmendi vendosjen e kamerave në të gjithë qytetin si një nismë e kësaj bashkie në drejtim të forcimit të sigurisë publike.

Në fjalën e saj përshëndetëse, **ambasadorja e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, znj. Guusje Korthals Altes theksoi se bashkëpunimi i mirë ndërmjet tri institucioneve polici-bashki-prokurori dhe ndërveprimi me të gjithë grupet e interesit janë**

thelbësorë për rendin dhe sigurinë publike në vend. Gjithashtu, ambasadorja vlerësoi se me rëndësi të veçantë për policinë e shtetit mbetet forcimi i integritetit dhe rritja e besimit të qytetarëve. Gjithashtu, në këtë përpjekje të përbashkët institucionale janë thelbësorë kontributi i shoqërisë civile dhe publikut në tërësi. Vetëm duke vendosur një dialog të hapur, institucionet mund të kryejnë më mirë punën, përmirësojnë rendin dhe sigurinë publike.

Sipas prokurores së rrethit Elbasan, znj. Pranvera Stafa, baza për parandalimin dhe zbulimin e veprave penale mbetet në bashkëpunimin e mirë ndër-institucional me policinë dhe bashkinë. Ajo u shpreh se masat e marra nga secili institucion i shërbejnë rritjes së sigurisë publike. Në këtë aspekt, prokuroria e rrethit Elbasan u shpreh e hapur ndaj çdo bashkëpunimi dhe komunikimi të vazhdueshëm me institucionet vendore.

Shefi i komisarariatit Librazhd përmendi se ndër veprat penale më të shpeshta janë ato të lidhura me pronën. Ndërkohë, komisarati i policisë ka marrë masa për forcimin e bashkëpunimit me bashkinë dhe prokurorinë për të rritur parametrat e sigurisë. Gjithashtu shërbimi ndaj komunitetit ka qenë në qendër të vëmendjes përmes krijimit të zonave policore, hapja e zyrës pritëse të qytetarëve dhe zhvillimi i takimeve të përbashkëta me bashkinë e grupet e interesit.

Ndërsa Drejtori i Policisë Vendore Elbasan z. Altin Qato u shpreh se “ne do ta kultivojmë më tej këtë nismë për ta shtrirë në njësitë administrative dhe në takime periodike me grupet e interesit”. Plani i policisë është që të vijohet me takimet periodike me grupet e interesit. Prioritet për ne është shndërrimi i policimit në komunitet nga filozofi në praktikë, tha z. Qato. *Ai kërkoi nga bashkia mbështetje në sigurimin e një mjedisi të përshtatshëm për oficerët e policisë për të ofruar sa më mirë shërbimin tek qytetarët tashmë pas ndarjes së zonave policore.* Ai gjithashtu nënvizoi disa nga problematikat

më të mprehta për komunitetin duke përfshirë sigurinë në shkolla, investimi me kamera në të gjithë qytetin, etj.

Gjatë diskutimeve, përfaqësuesi i një njësie administrative ngriti shqetësimin e drejtuar më herët pranë bashkisë dhe policisë për mungesën e sinjalistikës së përshtatshme në rrugët e sapo asfaltuara, të cilat bëhen shkak për aksidente rrugore.

Gjithashtu, përfaqësuesi i Kishës Ortodokse dhe imami i Xhamisë së qytetit nënvizuan nevojën për të thyer paragjykimet sociale dhe forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve vendore dhe komunitetit, e veçanërisht të rinjve.



MAT: GRUPI RINOR “ZËRI 16+” KËRKOI MARRJEN E MASAVE MBI SHQETËSIMET E TË RINJVE NË SHKOLLA

Shefi Komisarariatit të Policisë Mat z. Henerigert Mitri, në bashkëpunim me Kryetarin e Bashkisë z. Nezir Rizvani dhe drejtuesin e prokurorisë së rrethit z. Hysni Vata zhvilluan së bashku më aktorët vendorë takimin llogaridhënës mbi punën dhe sfidat e mëtejshme për rendin dhe sigurinë publike të kësaj bashkie.

Në fjalën e tij z. Rizvani u shpreh optimist për këtë format takimi. Ai nënvizoi bashkëpunimin e mirë me policinë, por që ky bashkëpunim duhet te forcohet përtej fokusit në raste të caktuara. Ai gjithashtu theksoi nevojën për një vëmendje më të madhe nga ana e institucioneve për zonat rurale.

Prokurori, z. Vata u shpreh se ky takim ishte një përvojë e munguar për qytetin duke qenë se të gjitha institucionet e kanë detyrim ligjor angazhimin në parandalimin dhe raportimin e rasteve problematike.

Ndërsa në fjalën e tij z. Mitri përmendi se Burreli për vitin e kaluar ka qenë ndër rrethet me më pak ngjarje kriminale. Sipas tij, policia ka hedhur hapa të mirë në vendosjen e komunikimit të vazhdueshëm me drejtuesit e shkollave për shqetësime të ndryshme. Megjithatë “kushtet e vështira social-ekonomike dhe terreni

i vështirë janë një sfidë për policinë që t’i përgjigjet në kohë reale të gjitha problematikave” është shprehur ai.

Pjesëmarrësit përfaqësues të grupit rinor “Zëri 16+” shtruan për diskutim dhe kërkuan nga autoritetet marrjen e masave për disa shqetësime të të rinjve lidhur me përdorimin e lëndëve narkotike, rasteve të dhunës fizike apo fenomenit të bullizmit në shkolla. Një nga problemet më të mprehta që u evidentua nga të rinjtë ishte edhe mbajtja e mjeteve të rrezikshme nga nxënës të caktuar në ambientet e shkollës.

Përfaqësuesi i prokurorisë dhe policisë në përgjigje të këtyre shqetësimeve, u angazhuan për të shtuar komunikimin me drejtuesit e shkollave, psikologun dhe mësuesit për të identifikuar këto raste. Me këtë rast ai ftoi të pranishmit të jenë më proaktivë në raportimin e shkeljeve të ndryshme.

Gjithashtu, kryetarët e fshatrave theksuan si problematikë të vazhdueshme qarkullimin e automjeteve me shpejtësi të madhe duke u bërë shkak për aksidente në rrugët rurale.





PLANI I INTEGRITETIT

PLANI I INTEGRITETIT NË KOMISARIATIN NR. 1 TIRANË

Në numrat e mëparshëm të këtij buletini janë analizuar në tërësi elementët, faza përgatitore dhe ajo e identifikimit të riskut të integritetit për hartimin e Planit të Integritetit (PI) për komisaratin Nr. 1 në Tiranë. Në këtë numër do të paraqesim komponentët e fazës së tretë dhe trajnimeve të zhvilluara për këtë fazë.

Faza 3: Vlerësimi i risqeve të integritetit në komisaratin nr.1

Kjo fazë konsiston në vlerësimin e intensitetit të risqeve të identifikuara sipas veprimtarisë së katër seksioneve të komisarimit nr. 1. Grupi i punës shqyrtoi Procedurat Standarde të Veprimit të strukturave operationale përkatëse:

- Procedura Standarde e Hetimit të Krimeve;
- Procedura Standarde e Ruajtjes dhe Sigurisë së Objekteve;
- Procedura Standarde e Trajtimit të

- Menaxhimit të Konfliktëve;
- Procedura Standarde e Policimit në Komunitet;
- Procedura Standarde e Patrullimit dhe Patrullës së Përgjithshme.

Grupi i punës identifikoi risqet/ngjarjet e mundshme të çdo nën procesi të evidentuara nga procedura standarde përkatëse. Në vlerësimin e risqeve të identifikuara u morën në konsideratë masat e kontrollit për çdo risk. Risqet apo ngjarjet e identifikuara u vlerësuan në lidhje me:

- mundësinë e ndodhjes së një ngjarjeje të padëshiruar kur nuk ka aktivitete kontrolli ose kur ato janë të pamjaftueshme për të parandaluar apo ulur riskun; si edhe
- pasojën që një ngjarje e padëshiruar do të kishte në zonën që operon komisarati nëse do të ndodhte. Pasoja mund të jetë një lloj dëmi që shkaktohet ose mundësi që nuk shfrytëzohet.

Mundësia e shfaqjes së riskut dhe pasoja e tij, ndahet në tre kategori vlerësimi: i lartë/i moderuar/ i ulët, sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela 1. Klasifikimi i vlerësimit të mundësisë së ndodhjes së një risku dhe vlerësimi i impaktit të shfaqjes së tij.

Vlerësimi	Rezultati	Vlerësimi i mundësisë/probabilitetit të shfaqjes së riskut	Vlerësimi i pasojës së shfaqjes së riskut
I ulët	1	Risku nuk është shfaqur në të kaluarën ose shfaqet shumë rrallë, kështu që nuk ka gjasa që kjo të ndodhë në të njëjtën periudhë kohore në të ardhmen.	Pasoja për integritetin e komisarimit është e parëndësishme.
I moderuar /i mesëm	2	Risku është shfaqur në një numër rastesh në të kaluarën, kështu që probabiliteti i ndodhjes në të njëjtën periudhë kohore në të ardhmen është i moderuar.	Pasoja është e rëndësishme për integritetin e komisarimit.
I lartë	3	Risku shpesh është shfaqur në të kaluarën dhe ekziston një gjasë e madhe që kjo të ndodhë në të njëjtën periudhë kohore në të ardhmen.	Pasoja është shumë e rëndësishme për integritetin e komisarimit.

Vlerësimi i riskut nënkupton renditjen e risqeve të integritetit duke filluar nga risqet më prioritare që paraqesin impakt thelbësor në integritetin e komisariatit dhe që mund të rrezikojnë eficientësinë dhe reputacionin e tij deri te risqet e ulëta të cilat nuk mund të kenë nevojë për masa por mjafton të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.

Renditja e risqeve bëhet sipas rëndësisë. Rezultati i prodhimit të mundësisë së ndodhjes së një risku me pasojën që ai jep në integritetin e institucionit nëse ai ndodh/shfaqet, jep një përgjigje për intensitetin e riskut të identifikuar (1 dhe

2 e ulët, 3 dhe 4 e mesme dhe 6 dhe 9 e lartë - tabela nr.2).

Për shembull, në një situatë ku grupi i punës vlerëson se “mungesa në burime njerëzore me oficerë të policisë gjyqësore në seksionin e hetimit të krimit për të mbuluar në kohë të gjitha ngjarjet, do të shfaqet dhe përsëritet më shumë se një herë” dhe se “impakti është shumë i rëndësishëm për performancën dhe integritetin e komisariatit”, prodhimi $3 \times 3 = 9$, tregon që intensiteti i riskut është i lartë dhe marrja e masave për zvogëlimin e këtij risku janë imediate.

Tabela 2. Vlerësimi i intensitetit të riskut- Matrica e riskut

VLERËSIMI I INTENSITETIT TË RISKUT		VLERËSIMI I RISKUT		
		<i>Risku nuk është shfaqur në të kaluarën ose shfaqet shumë rrallë, kështu që nuk ka gjasa që kjo të ndodhë në të ardhmen (1)</i>	<i>Risku është shfaqur në një numër rastesh në të kaluarën, kështu që gjasat që kjo do të ndodhë në të ardhmen është e moderuar (2)</i>	<i>Risku shpesh është shfaqur në të kaluarën dhe ka gjasa të madhe që kjo të ndodhë në të ardhmen (3)</i>
PASOJAT E SHFAQJES SË RISKUT	<i>Impakti për integritetin e institucionit është i parëndësishëm (1)</i>	1	2	3
	<i>Impakti për integritetin e institucionit është i rëndësishëm (2)</i>	2	4	6
	<i>Impakti për integritetin e institucionit është shumë i rëndësishëm (3)</i>	3	6	9

Renditja e risqeve sipas prioriteteve shërben si bazë për përcaktimin e masave për trajtimin e risqeve të identifikuara. Përcaktimi i masave të prioriteteve bëhet në mënyrë që burimet zotërohen nga komisariati (burime financiare, njerëzore, infrastrukturore etj.) të akordohen sipas nevojave të mëdha. Risqet prioritare kërkojnë trajtim imediat me masa prioritare. Për risqet e kategorizuara si

të ulëta, mund të caktohet monitorimi i vazhdueshëm ose periodik i efikasitetit të masave ekzistuese, ose masa të tjera shtesë, sipas rastit. Trajtimi i risqeve bëhet edhe përmes aktiviteteve të kontrollit që mund të jenë rregulla, procedura dhe veprime të cilat kanë për qëllim reduktimin e risqeve të integritetit për arritjen e objektivave.

SERIA E TAKIMEVE PUBLIKE LLOGARIDHËNËSE PËR PARANDALIMIN E KRIMIT

BASHKIA TIRANË /NJËSIA NR. 7 & NR. 5: KOMUNIKIMI I VAZHDESHËM ME POLICINË I DOMOSDOSHËM PËR NDARJE MË TË MIRË TË PËRGJEGJËSIVE INSTITUCIONALE

Në takimin e zhvilluar në Tiranë me përfaqësues të bashkisë, njësive administrative nr. 5, nr. 7 dhe komisariatit nr. 2 morën pjesë kryetarë lagjesh, ndërlidhësit e komunitetit, përfaqësues të institucioneve arsimore, të qeverisë së nxënësve dhe këshillit të prindërve, përfaqësues të biznesit dhe organizata jo-qeveritare. Z. Erindi Bejko, përfaqësues i Bashkisë Tiranë theksoi se ky format takimi është shumë i rëndësishëm pasi të tre institucionet vendore kryesore për sigurinë janë bashkë. “Shumica e ankesave sado banale në dukje mund të kthehen në konflikte më të mëdha. Ndaj komunikimi i vazhdueshëm edhe në kuadër të policimit në komunitet është shumë i rëndësishëm për të zgjidhur këto problematika pa u përshkallëzuar më tej”- nënvizoi z. Bejko. Njëherazi, ai vlerësoi bashkëpunimin e mirë të komisariatit Nr. 2 të policisë dhe njësive administrative nr. 5 dhe 7 si të suksesshme deri më



tani. *Komunikimi i vazhdueshëm me policinë që nga baza, p.sh. që nga administratori i pallatit e në strukturat më lart mund të krijojë lehtësi në ndarjen e përgjegjësive për të zgjidhur shqetësimet e komunitetit.* “Si njësia nr. 5 ashtu edhe njësia nr. 7 janë në pararojë për jetesën në komunitet”, tha ai.

Shefi i Policimit në Komunitet në Komisariatit Nr. 2, z. Arjan Demça nënvizoi faktin se policia është një prej institucioneve ku qytetarët drejtohen për çështje që kanë të bëjnë me cilësinë e jetesës. *“Sektori i policimit në komunitet prek shumë fusha si: problematikat e fëmijëve në situatë rruge, siguria dhe rendi në tërësi, etj. Në këtë aspekt, shumica e sinjaleve vijnë nga qytetarët. Në njësinë Nr. 5 janë atashuar efektivë të policisë dhe është vendosur bashkëpunim i mirë me të dy njësitë 5 dhe 7 sipas problematikave që kanë hasur këto njësi”- theksoi ai.*

Një përfaqësues nga komuniteti i zonave të njësive administrative sugjeroi nevojën e pjesëmarrjes së një përfaqësuesi të policisë bashkiake në takim si dhe evidentoi mungesën e një roli më pro-aktiv nga ana e policisë bashkiake, veçanërisht

në kontrollin e zënies së hapësirave publike.

Ndërsa, Z. Rebani Jaupi, Drejtues i Policisë vendore Tiranë, në fjalën e tij falenderoi IDM-në për kontributin prej shumë vitesh tashmë në krijimin e një policie bashkëkohore. *Përmes strategjisë së policimit në komunitet po punohet për forcimin e punës së policisë me qytetarët. Në këtë kuadër, drejtoritë e shkollave kanë një kontribut të rëndësishëm në rritjen e kërkesës së llogarisë ndaj policisë dhe ne jemi të angazhuar për të qenë prezent në të gjithë shkollat (gjatë fluksit të lëvizjes së nxënësve) dhe për trajtimin e problematikave që lidhen me tregtimin e lëndëve narkotike në afërsi të shkollave.* Lidhur më këtë të fundit, policia ka bërë vizita të befasishme në shkolla. Më tej, Z. Jaupi theksoi se policia është e hapur ndaj çdo lloj problematike që evidentohet nga komuniteti dhe solli në vëmendje numrin 112 dhe aplikacionin komisarati dixhital



për një komunikim më të shpejtë me policinë.

Gjatë diskutimeve një administrator pallati vuri në dukje si problematikë mungesën e bashkëpunimit të policisë bashkiake dhe asaj të shtetit. Ai vlerësoi rëndësinë e këtij formati takimesh për të parandaluar dhe zgjidhur problemet që shqetësojnë komunitetin. Më tej u vijua me ngritjen e një shqetësimi lidhur me ndërtimet pa leje në prag të zgjedhjeve ku pavarësisht raportimeve, nuk janë marrë masa as nga policia bashkiake dhe as nga ajo e shtetit.

QYTETARËT NË KAMËZ: NIVELI I ULËT I ZBULUESHMËRISË SË NGJARJEVE KRIMINALE DHE PANDËSHKUESHMËRIA E SHKELËSVE TË LIGJIT SHKAK PËR BESIMIN E ULËT TEK INSTITUCIONET

Takimi llogaridhënës në bashkinë Kamëz, mbledhi përfaqësues të bashkisë Kamëz, kryetarë të njëjësive administrative, mësues, nxënës dhe qytetarë. Në panelin kryesor të tij ishin pjesë nën-kryetari i bashkisë Kamëz, z. Tomorr Kotarja, prokurori në Prokurorinë e rrethit Tiranë z. Ervin Karanxha dhe shefi i policimit në komunitet z. Ali Allaraj.

Në fjalën e tij z. Kotarja vlerësoi pozitivisht rëndësinë e këtij takimi, veçanërisht



praninë e përfaqësuesve nga institucione të ndryshme dhe të qytetarëve. Duke vënë theksin tek nevoja për të rritur besimin tek institucionet publike për të raportuar shqetësimet e komunitetit, ai tha se “këto lloj takimesh kërkojnë kurajën qytetare, e cila ndërton të ardhmen, zhvillimin dhe mirëqenien e komuniteteve”.



Nga pikëpamja e sigurisë, prokurori Karanxha dhe shefi i policimit në komunitet u kërkuan të pranishmëve të ishin sa më aktivë dhe sa më të hapur në raportimin e shkeljeve dhe në bashkëpunimin me institucionet e policisë dhe të prokurorisë.

Z. Karanxha në mesazhin e tij kryesor tha se “publiku duhet të edukohet mbi rëndësinë e denoncimit si një instrument mjaft i rëndësishëm në parandalimin e krimit. Qytetarët duhet të ndryshojnë perceptimin dhe kuptueshmërinë e tyre mbi denoncimin, sepse të denoncosh nuk do të thotë të spiunosh, por është një veprim që duhet vlerësuar nga institucionet tona. Sepse ne kemi nevojë për qytetarët”.

Megjithatë, qytetarët e pranishëm evidentuan disa problematika në lidhje me arsyet e uljes së besimit nga qytetarët tek institucionet ku rol të rëndësishëm ka luajtur niveli i ulët i zbulueshmërisë së e rasteve të vjedhjeve dhe ngjarjeve kriminale të ndodhura ndër vite si dhe

pandëshkueshmëria e personave me influencë.

Shefi i policimit në komunitet vlerësoi modelin e policimit në komunitet si një nga format që deri më tani ka dhënë rezultat sa i përket komunikimit dhe marrëdhënies me qytetarët. I njëjti vlerësim u dha dhe nga psikologjia e gjimnazit Kamëz, e cila kërkoi gjithashtu nga policia që të ishte më e pranishme në shkollë, jo vetëm në kuadër të patrullimit, por edhe të bashkëbisedimit me nxënësit e prindërit dhe jo vetëm në shkollat e qytetit, por edhe të atyre të fshatit.

Qytetarë të pranishëm në takim, prindër e nxënës evidentuan disa nga problematikat në zonat e tyre, si: siguria rrugore pranë shkollave, veçanërisht mungesa e sinjalistikës e cila shpesh është bërë burim aksidentesh.

Në takim ishin të pranishëm dhe përfaqësues të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA), të cilët prezantuan shkurtimisht veprimtarinë e këtij institucioni si dhe qasjen e tyre mbi marrëdhënien me publikun.

Për më shumë informacion si dhe për dërgesë të opinioneve, përfaqësuesit e institucioneve vendore mund të na kontaktojnë në adresën e email: info@idmalbania.org ose tel: 042400241.

POLICI

BASHKI

PROKURORI

INTEGRITET



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Kingdom of the Netherlands